



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Lushnjë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikualifikim i rrugës “Misto Mame” Bashkia Lushnjë

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233140-2 –
Punime rrugore**

VLERA E FONDIT LIMIT: 108 279 322,57 (njëqind e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH** dhe **129 935 187,08** (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë zero tetë) **Lekë me TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Lushnjë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,**
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se : 108 279 322,57 (njëqind e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.** *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare **2024, 2025**, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e kërkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin e fundit (këstet e maturuara)** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për **vitin e fundit (këstet e maturuara)**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe neni 43, neni 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

Meqënëse operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **54 139 661,28** (pesëdhjetë e katër milion e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet e tetë) **Lekë pa TVSH**, (50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose,
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se **216 558 645,14** (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pikë katërmëdhjetë) **Lekë pa TVSH** (dyfishi i vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet)

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

pika 2.3.1 duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë,

anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.4 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licensë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **N.P. 4 D** (Rrugë autostrada,ura,mbikalime,hekurudha,linja tramvai,metro,hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- **N.S. 18 A** (Punime topogjeodezike)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr.42, datë 16.01.2008 i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 8 ku përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

N.P. 4 - D (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Për punime në rrugë dhe sheshe pavarësisht nga shkalla e tyre e vështirësisë. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit në zërat:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA
		1. PUNIME GERMIMI		
1	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	3900
2	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	20
		SHUMA 1:		
		2. PUNIME DHEU		
3	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	3900
4	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	20
		SHUMA 2:		
		3. ANALIZA TEKNIKE		

5	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	9000
6	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	9000
		SHUMA 3:		
		4. PUNIME SHTRESASH		
7	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	8500
8	3.212/a	Shtrese stabilizanti t=5cm	m2	9000
9	3.164/1 b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	300
10	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	1400
11	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	400
12	3.212	Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	600
13	3.164/1 b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	420
14	3.632	Heqje pllaka trotuari	copë	3300
		SHUMA 4:		
		5. PRISHJE		
15	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	120
16	2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	60
		SHUMA 5:		
		6. PUNIME TE NDRYSHME		
17	3.617	F.V. Bordura betoni 15x35 cm	m	1225
18	3.616/b	F.V. Bordura betoni 15x30cm	m	730
19	3.654/1	F.V. Tuba plastmasi ø 80	m	1000
20	3.619/a	F.V. Bordura betoni 6x20 cm	m	2000
21	3.654	F.V. Tuba plastmasi ø 100	m	2000
22	3.643/a	F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber)	m3	75
23	3.643	Mbjellje bari ne skarpat	m2	500
		SHUMA 6:		
		7. PUNIME SHTRESASH 2		
24	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	98
25	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10	m3	58
		SHUMA 7:		

		8. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
26	3.164/2 t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml	1470
27	3.164/1 t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	90
28	3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	43
29	3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	43
30	3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	63
31	3.172	F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	copë	1
32	3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xingura 50x3mm L=150cm	copë	63
		SHUMA 8:		
		9. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME		
33	3.583	Ndertim Pusete kontrolli b/a 1x1x1.5 m	copë	45
34	3.584	Ndertim Pusete kontrolli b/a, 1x1x2 m me kapak gize	copë	5
35	3.405	Prishje struktura prej guri	m3	45
36	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m3	45
		SHUMA 9:		
		10. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHEM		
37	2.342	Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	copë	68
38	2.341	Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize	copë	3
39	2.336	Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	copë	10
		SHUMA 10:		
		11. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE		
40	2.523/1	F.V. Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	470
		SHUMA 11:		
		12. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE		
41	2.258/2	Shtrese zhavori	m3	147
42	2.261/a	Nenshtrese rere	m3	32
43	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2	2050
44	2.258/2	Shtrese zhavori	m3	4
45	2.294	Heqje bordura trotuari ekzistues	ml	1200
46	2.258/2	Shtrese zhavori	m3	200

		SHUMA 12:		
		13. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESH. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE		
47	3.955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	84
48	3.966	F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m)	copë	200
49	3.960	F.V. Fidane Lule dekorative	copë	100
		SHUMA 13:		
		14. B. SINJALET HORIZONTALE		
50	3.942	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)	ml	3975
51	3.946	Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (sprajt)	m2	260
		SHUMA 14:		
		15. INSTALIME PER NDRICIM		
52	2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur	ml	63
		SHUMA 15:		
		16. GAZ E NAFTESJELLES		
53	4.131/3.5	F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm2	m	400
		SHUMA 16:		
		17. PUNIME BETONI DHE B/A		
54	2.112	Mure buto betoni C 12/15	m3	44
55	2.112	Mure buto betoni C 12/15	m3	35
		SHUMA 17:		
		18. PUNIME ASFALTIMI		
56	3.221/1	Shtrese binderi me granil gur kave,4cm,me makineri	m2	1500
		SHUMA 18:		
		19. PUNIME SHPYLLEZIMI		
57	3.6	Preje e sistemim pemesh ø > 76 cm	copë	10
		SHUMA 19:		
		20. PUNIME MURATURE TULLE		
58	2.64/2	Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25	m3	35
		SHUMA 20:		
		21. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
59	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	2
60	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	55
		SHUMA 21:		
		22. PUNIME HEKUR BETONI		
61	2.182	F.V. Konstruksione metalike te thjeshta.	ton	1.5
62	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	2
		SHUMA 22:		

		23. ANALIZA JASHTE LISTE		
63	An	F.V. Ne toke kablo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x6mm ²	m	600
64	An	F.V. Kablo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x4mm ²	m	300
65	An	F.V Percjelles elektrik FS -17 3X2.5 mm ²	ml	344
66	An	F.V Ndricues Led 100 W	copë	43
67	An	Shtresë betoni (C16/20 me zgarë hekuri) me stampim t = 15 cm	m ²	400
68	An	Shkalle betoni me zmerilim (C16/20 me zgarë hekuri) t = 20 cm	m ²	400
69	An	Ngritje pushtash ekzistuese _ 20 cm	copë	40
70	An	Trotuar me pllaka granili me bojë	m ²	5400
71	An	F.V. stola dekorative	copë	25
72	An	F.V. Shtylla metalike dekorative me ndricim H=5m (komplet)	copë	20
73	An	Veshje mermeri t=2cm	m ²	150
74	An	Sheshe betoni me zmerilim (C16/20 me zgarë hekuri) t = 10 cm	m ²	600
		SHUMA 23:		

N.S. 18 - A (Punime topogjeodezike)

Për punime topogjeodezike të nevojshme gjatë kryerjes së punimeve në të gjitha proceset. Për këtë gjë është kërkuar ky zë licence.

2.4.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Teknik Ndertimi
- 1 (një) Topograf
- 2 (dy) Elektriçist
- 1 (një) Saldator

Per te vertetuar personelin duhet:

- Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, deshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune, diplomat ose kualifikimet për punonjës të specializuar/të kualifikuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi - Për njohjen me projektin dhe zbatimin në kohë e në cilësi të tij. Organizimin e rradhës së punimeve sipas preventivit dhe grafikut të punimeve. Mbajtjen e proces verbaleve dhe akt-kontrolleve për cdo fazë të projektit. Hartimin e librezës së masave, ditarin e punimeve, situacioneve pjesore dhe përfundimtar
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik - Për interpretimin e projektit dhe për udhëheqjen e punëtorëve në zbatimin e tij për punimet hidraulike të paraqitura në preventiv dhe grafikun e punimeve. Detyrat e tij janë të përshkruara si më sipër
- 1 (një) Inxhinier Elektrik - Për interpretimin e projektit dhe për udhëheqjen e punëtorëve në zbatimin e tij për punimet elektrike të paraqitura në preventiv dhe grafikun e punimeve.
- 1 (një) Teknik Ndërtimi - Për zbatimin e punimeve që janë parashikuar të kryhen. Koordinimin e punimeve për zbatimin e tyre në kohë si dhe në cilësi. Zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike, të furnizimit dhe të marrëdhënieve të grupeve të ndryshme të punës për respektimin korrekt të preventivit dhe grafikut të punimeve.
- 1 (një) Topograf - Për zbatimin e projektit duke iu referuar kuotave të projektit. Në preventive kemi zera për sistemin e territorit dhe gjithashtu dhe punimet e drenazhit. për vendosjen e kuotave sipas projektit dhe për një rrjedhshmëri të ujërave kërkohet topografi të vendosi kuota sa më të sakta.
- 2 (dy) Elektriciist - Për zbatimin e projektit elektrik që do të kryhet në objekt kërkohen elektriciistë për zbatimin e tij në afat dhe në cilësi.
- 1 (një) Saldator - Për saldimin e kangjellave të murit rrethues.

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndertimi dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998, i ndryshuar.

2.4.3 Një punësim mesatar i të paktën **38 (tridhjetë e tetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e

informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Çertifikatën e sistemit të menaxhimit të trafikut rrugor **ISO 39001 -2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i*

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të siguri dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 / ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e siguri dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 është standard ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). Njësia e Prokurimit gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **207 (dyqind e shtatë) ditë kalendarike**

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Eskavator min. 0.25 m ³	1 copë	Pronësi ose me qira
Eskavator min. 2 m ³	1 copë	Pronësi ose me qira

Rrul kompresor me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qira
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qira
Spërkatës Boje për vijëzime në rrugë	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qira
Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton	3 copë	Pronësi ose me qira
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamioncinë deri në 3.5 ton	3 copë	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qira
Fabrikë betoni	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Fabrikë Asfaltobetonit	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç deri 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Betoniere min. 0.5 m ³	2 copë	Pronësi ose me qira
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qira
Kallëpe	min. 150 m ²	Pronësi ose me qira
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Zmeriletriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri për skarifikim shtresash rrugore	1 copë	Pronësi ose me qira
Instrument për punimet gjeodezike	1 copë	Pronësi ose me qira

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, më konkretisht: -leja e qarkullimit; certifikatën e pronësisë; -certifikatën e kontrollit teknik; policën e sigurimit (siguracionin) e vlefshme; Certifikatën e transportit e vlefshme; taksat vjetore dhe fotot përkatëse në secilën anë të mjetit/pajisjes, ku në rastet e mjeteve të targuara në foto duhet të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;
- (b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e punimeve, deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për fabrikën e betonit dhe fabrikën e asfaltobetonit duhet të paraqitet dokumenti që verteton pronësinë, kontrata e marrjes me qira ose aktmarrëveshjen për furnizim.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Arsyetimi teknik për disponimin e mjeteve :

Ekskavator me goma min. 0.25 m³ (copë 1)

Për gërmimin e materialeve, në preventiv janë 3920m³ gërmim dheu me ekskavator.

Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton (copë 3)

Këto mjete do të përdoren për largimin e materialit të gërmuar dhe sjelljen e materialeve të kërkuara të objektit. Në preventiv kemi transport materiale ndërtimi dheu 3920 m³, shtresë binderi 6 cm 9000 m², shtresë asfaltbetoni 4 cm 9000m², skarifikim shtrese asfalti ekzistues 8500 m², shtresa stabilizanti t = 5 cm: 9000 m², mbushje me çakëll në trupin e rrugës 720 m³, shtresa stabilizanti t = 15 cm: 1400 m², shtresa stabilizanti t = 20 cm: 400 m², shtresë çakëlli t=10/15 600 m², Bordura betoni 15x35 cm 1225 m, Bordura betoni 15x30 cm 730 m, Bordura betoni 6x12 cm 2000 m, shtresë zhavori 351 m³, nënshtresë rëre 32 m³, shtresë binderi 4 cm 1500 m², dhe vegjetal 75 m³, shtylla metalike për ndriçim 43 copë, heqje bordura trotuari ekzistues 1200 ml, mur me tulla 35 m³, Trotuar me pllaka granili 5400 m², tuba të brinjëzuar d=400 mm 1470 ml, tuba të brinjëzuar d=315 mm 90 ml, tuba të brinjëzuar d=200 mm 470 ml, trotuar me pllaka 2050 m², prishje struktura guri 45 m³, prishje struktura prej betoni 45 m³

Autobitumatrice (copë 1)

Duhet për shpërndarjen e emulsionit të bitumit gjatë procesit të asfaltimit

Asfaltoshtruese (copë 1)

Për hedhjen ,përhapjen shtrimin e shtresës së binderit dhe asfaltbetonit. Në preventiv kemi shtresë binderi 6 cm 9000 m², shtresë asfaltbetoni 4 cm 9000m², shtresë binderi 4 cm 1500 m²,

Rrul kompresor me vibrim (copë 1)

Mjet që përdoret për njëtrajtësimin e shtresave të rrugës.

Në preventiv kemi shtresë binderi 6 cm 9000 m², shtresë asfaltbetoni 4 cm 9000m², shtresa stabilizanti t = 5 cm: 9000 m², mbushje me çakëll në trupin e rrugës 720 m³, shtresa stabilizanti t = 15 cm: 1400 m², shtresa stabilizanti t = 20 cm: 400 m², shtresë çakëlli t=10/15 600 m², shtresë binderi 4 cm 1500 m²,

Fabrikë asfaltbetoni (copë 1)

Prodhimi i asfaltbetonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. në bazë të preventivit janë shtresë binderi 6 cm 9000 m², shtresë asfaltbetoni 4 cm 9000m²,

Makineri për skarifikim shtresash rrugore (copë 1)

Duhet për skarifikimin e asfaltit ekzistues. Në preventiv kemi 8500 m² skarifikim shtrese asfalti ekzistues.

Grejder (copë 1)

Për shpërndarjen dhe nivelimin e materialit të nënshtresave. Në preventiv janë shtresa stabilizanti t = 5 cm: 9000 m², shtresa stabilizanti t = 15 cm: 1400 m², shtresa stabilizanti t = 20 cm: 400 m², shtresë çakëlli t=10/15 600 m²

Autobot uji (copë 2)

Për sjelljen e sasisë së nevojshme të sasisë së ujit që nevojitet për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen si në shtresën e stabilizantit ,çakëllit . Në preventiv janë shtresa stabilizanti t = 5 cm: 9000 m², mbushje me çakëll në trupin e rrugës 720 m³, shtresa stabilizanti t = 15 cm: 1400 m², shtresa stabilizanti t = 20 cm: 400 m²,

Ekskavator min. 2m³ (copë 1)

Për shpërndarjen e materialit të shtresave si në mbushje me çakëll e gur gurore 720 m³,

Autobetoniere (copë 2)

Per transportin e betonit të marrë nga nyjet e prodhimit të betonit si dhe për të patur cilësi të betonit. Në preventiv kemi shtresë betoni C 16/20 98m³, shtresë betoni C 7/10 58m³, mure buto betoni C 12/15 79 m³, shtresë betoni me zgarë hekuri me stampim 400 m², shkallë betoni me zmerilim 400 m², sheshe betoni me zmerilim 600 m², Struktura të holla monolite C 16/20 55 m³, puseta kontrolli b/a 1x1x1.5m 45 copë, puseta kontrolli b/a 1x1x2m 5 copë, puseta shiu 40 x 60m 68 copë, puseta shiu 40 x 60m 68 copë, puseta shiu 40 x 40m 3 copë, pusetë shkarkimi 80x80 10 copë

Autopompë betoni (copë 1)

Për hedhjen e betonit nga autobetonieria në objekt, Në preventiv kemi betoni me zgarë hekuri me stampim 400 m², shkallë betoni me zmerilim 400 m², sheshe betoni me zmerilim 600 m², Struktura të holla monolite C 16/20 55 m³

Fabrikë betoni (copë 1)

Prodhimi i betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit te tij. Në preventiv kemi shtresë betoni C 16/20 98m³, shtresë betoni C 7/10 58m³, mure buto betoni C 12/15 79 m³, shtresë betoni me zgarë hekuri me stampim 400 m², shkallë betoni me zmerilim 400 m², sheshe betoni me zmerilim 600 m², Struktura të holla monolite C 16/20 55 m³, puseta kontrolli b/a 1x1x1.5m 45 copë, puseta kontrolli b/a 1x1x2m 5 copë, puseta shiu 40 x 60m 68 copë, puseta shiu 40 x 40m 3 copë, pusetë shkarkimi 80x80 10 copë

Zmeriletriçe (copë 1)

Për punimet e shkallëve dhe shesheve. Në preventiv kemi shkallë betoni me zmerilim 400 m², sheshe betoni me zmerilim 600 m²

Spërkatës Boje për vijëzime në rrugë (copë 1)

Për realizimin e zërit: Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me bojë bikomponente me gjerësi 12 cm 3975 ml, vijëzimet e kalimit të këmbësorëve me bojë bikomponente 260 m².

Elektrosaldatrice (copë 1)

Për saldimin e kangjellave të rrethimit, Në preventiv janë 1.5 ton konstruksione metalike të thjeshta.

Kamionçinë deri 3.5 ton (copë 3)

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta sjelljen e tyre në objekt dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit si: Në preventiv janë 1.5 ton konstruksione metalike të thjeshta për kangjellat e rrethimit, kablllo fuqie Cu 4x6mm² 600 m, kablllo fuqie Cu 4x4mm² 300 m, përcjellës elektrik 3x2.5mm² 344 ml, Ndryqes LED 100W 43 copë, krah shtylla metalike 43 copë, pusëtë plastike 40x40x40 63 copë, kuadër komandimi 1 cop, elektroda tokëzimi 63 copë, kablllo fuqie Cu 4x10mm² 400 m, përcjellës tokëzimi 63 ml, tabela rrugore 84 copë, Mbjellje pemë dekorative bli 200 copë, fidanë lule dekorative 100 copë, veshje mermeri 150 m², hekur betoni periodik 2 ton,

Autovinç deri 5 ton (copë 1)

Për vendosjen e ndryqesve LED dhe krah shtylla metalike, në preventiv janë FV ndricues Led 100 W :43 copë, Shtylla metalike dekorative me ndriçim komplet 20 copë, krah shtylla metalike 43 copë,

Vibrator (copë 2)

Kërkohet për vibrimin e betonit. Në preventiv kemi, punime betoni në të cilën kërkohet vibrator. Konkretisht: mure buto betoni C 12/15 79 m³, Struktura të holla monolite C 16/20 2 m³, puseta kontrolli b/a 1x1x1.5m 45 copë, puseta kontrolli b/a 1x1x2m 5 copë, puseta shiu 40 x 60m 68 copë, puseta shiu 40 x 40m 3 copë, pusëtë shkarkimi 80x80 10 copë

Kallëpe (min 150 m²)

Për realizimin e mure buto betoni C 12/15 79 m³, Struktura të holla monolite C 16/20 2 m³, ngritje pusetash ekzistuese 40 copë, puseta kontrolli b/a 1x1x1.5 45 copë, puseta kontrolli b/a 1x1x2m 5 copë, puseta shiu 40 x 40m 3 copë, pusëtë shkarkimi 80x80 10 copë

Betoniere min. 0.5 m³ (copë 2)

Për realizime në sasi dhe detaje të vogla betoni të zërave të preventivit. Struktura të holla monolite C 16/20 2 m³, ngritje pusetash ekzistuese 40 copë, stola dekorativë 25 copë,

Matrapik (copë 2)

Për realizime të prishjeve, në preventive kemi prishje struktura guri 45 m³, prishje struktura prej betoni 45 m³

Instrument për punimet gjeodezike (copë 1)

Pajisje për piketimin dhe kuotimin e shesheve dhe mureve.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i

ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike”, sjellim ne vemendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST.

Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin

e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo veprim të kësaj veprimi sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.

Kriteret për kualifikim për procedurën respektive janë hartuar dhe vendosur në dispozicion për njohësin e prokurimit nga Komisioni i hartimit të kriterëve për kualifikim, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor me Nr.08, datë 07/01/2026,

Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Specifikimet teknike, Relacioni teknik dhe janë sipas materialit i cili është publikuar sëbashku me dokumentet e tenderit të hartuar nga specialistët e fushës, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Lushnjë, në përputhje me detyrat funksionale që ajo ushtron.

Shënim: *Në zbatim të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në DT, preventiv, specifikime teknike apo çdo dokument shoqëruar, është cituar ndonjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në çdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.*

Kudo në Specifikimet Teknike ku janë përcaktuar Standarte ndërkombëtare, mund të paraqiten edhe standarde shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në Specifikimet Teknike bashkëlidhur DST, në fjalitë ku është përmendur Standardi European UNI 2332 , ose i ngjashëm me të, mund të paraqitet edhe standardi SSH/UNI/EN mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.)

Në Specifikimet Teknike bashkëlidhur DST, në fjalitë ku janë përmendur standartet : “ ISO 4012,ISO 1920,ISO 7030,ISO 6275,BS 8110” ose të ngjashëm me këto,mund të paraqiten edhe standarde kombëtare SSH/ISO/BS mbi konformitetin e standardeve europiane, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.”

- Fondi limit për këtë prokurim është përllogaritur mbështetur në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”
- Udhëzimin nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Kodet e profesionit janë bazuar në vendimin nr.514, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar.
- Kërkohet prezenca e stafit teknik për realizimin e punimeve pa përcaktuar marrëdhëniet juridike të punësimit gjithashtu mënyra se si sigurohen këto makineri(pronësi, qera apo aktmarrëveshje furnizimi) nuk është përgjegjësi e këtij komisioni.

NJËSIA E PROKURIMIT: